

V E N D I M
Nr. 429, datë 4.8.2000

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.90, DATË 25.2.1999, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR VLERËN E SHITJES SË APARTAMENTEVE TË
FINANCUARA, ME FONDE SHTETËRORE, NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 16 e 25, të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe të neneve 1 dhe 13, të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 90, datë 25.2.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerën e shitjes së apartamenteve të financuara me fonde shtetërore, nga Enti Kombëtar i Banesave” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Në këto raste në çastin e rillogaritjes, nëse qytetari bën pagesë të menjëhershme, i njihet e drejtja e uljes së detyrimit financiar të mbetur, në çdo çast, në masën e përcaktuar në vendimin nr.4, datë 9.1.1995, të Këshillit të Ministrave. Masa përkatëse e uljes së detyrimit financiar të mbetur, përballohet nga buxheti i shtetit.”.

b) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“Qytetarët e trajtuar me banesë nga organet përgjegjëse, të cilët nuk kanë lidhur ende kontratat e shitblerjes së apartamenteve të financuara nga Enti Kombëtar i Banesave, brenda afatit njëmuor nga dita e lajmërimit prej tij, humbasin të drejtën e përfitimit të pronësisë së apartamentit, të ndërtuar ose blerë me fonde shtetërore dhe këtë të drejtë të përfitimit, Enti Kombëtar i Banesave ia kalon një personi të tretë duke zbatuar radhën në listat e të pastrehëve.”.

c) Pas pikës 6 shtohet dhe një paragraf me këtë përmbajtje:

Qytetarët të cilët janë pajisur me banesë të re nga organet përgjegjëse, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, me kusht dorëzimit të banesës së vjetër, në qoftë se nuk bëjnë dorëzimin e kësaj banese deri në çastin e lidhjes së kontratës së re, humbasin të drejtën e pajisjes me banesën e re dhe Enti Kombëtar i Banesave ia kalon një personi të tretë, duke zbatuar radhën në listat e të pastrehëve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta